



E enjte 5 Nëntor 2009  
ILO/09/00

**EMBARGO: Për publikim ose shfaqje mbas  
1200 GMT 5 Nëntor 2009**

**RËNIA E PËRGJITHSHME E PAGAVE REALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR MUND TË ULË NDJESHËM  
KONSUMIN DHE TË PËRSHPEJTOJË NGADALËSIMIN EKONOMIK**

**INSTITUTET DHE POLITIKAT E PAGAVE VUAJNË NGA NJË SËRË DOBËSISH STRUKTURALE**

SARAJEVË (Lajme nga ILO) – Në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2008 pati një ngadalësim të pagave reale ndërkohë që për vitin 2009 pagat reale dhe nominale pritet të bien edhe më shumë, si pasojë e shkurtimeve të pagave që janë ndërmarrë së fundmi. Rënia e pagave reale dhe nominale mund të përshpejtojë rënien e konsumit, dhe në këtë mënyrë, të ngadalësohet edhe më tej rimëkëmbja ekonomike e këtyre vendeve – thuhet në materialin<sup>1</sup> e përgatitur nga ILO për konferencën nënrajonale të nivelit të lartë mbi “Impaktin e krizës financiare dhe ekonomike: Përcaktimi i pagave dhe reagimi i politikave” që zhvillohet në Sarajevë të Bosnje-Hercegovinës në datat 5-6 Nëntor 2009. Në konferencë marrin pjesë delegacione trepalëshe nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova<sup>2</sup>, Mali i Zi dhe Serbia.

Përveç rënies së pagave reale, në vende si Bosnje-Hercegovina dhe Serbia, raportohen raste të mos-pagimit të pagave apo vonesave në pagimin e pagave. Kriza ka gjithashtu të ngjarë të rrisë pagesat informale në të holla ose pagat “në zarf”, me pasojë derdhjen e më pak kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shkatërrimin e mëtejshëm të niveleve tashmë të ulëta të pensioneve. Këto prirje do të kontribuojnë në frenimin e niveleve të konsumit. Në një sërë vendesh të Ballkanit Perëndimor vërehen tashmë shenja të rënies së kërkesës vendase. Për shembull në Serbi, kërkesa agregate për vitin 2008-2009 pësoi një rënie dyshifrore.

Ndërkohë që është e nevojshme të ndihmohen shoqëritë që të ruajnë nivelet e punësimit, politikat e pagave mund të ruajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e kërkesës dhe në kthimin e besimit. Politikat e pagave mund të ndihmojnë gjithashtu në zbutjen e varfërisë, e cila në Ballkanin Perëndimor është ende e lartë. Nivelet e pagave vazhdojnë të mbeten nga më të ulëtat në Evropë, duke qenë shpesh nën minimumin jetik. Me qëllim shmangien e kostos shoqërore masive nuk duhet të lejohet zvogëlimi në përgjithësi i pagave të ulëta.

*Përmirësimi i përcaktimit të pagës minimale*

Pakti Global për Vendet e Punës<sup>3</sup> i ILO-s, i pranuar nga vendet e G20 dhe vende të tjera, si pjesë e reagimit të menjëhershëm ndaj krizës, paralajmëron në lidhje me kërcënimin e spirales së pagave dhe deflacionit të çmimeve dhe sugjeron dialogun social, bisedimet kolektive dhe pagën minimale si mjete kundër deflacionit. Pakti i përshkruan pagat minimale si “një instrument të rëndësishëm politikash për mbrojtjen sociale” që mund të ndihmojë në reduktimin e varfërisë dhe pabarazive, rritjen e kërkesës, si dhe stabilitetin ekonomik. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë dy drejtime të kundërta përsa i përket pagave minimale: Disa vende, si Serbia, kanë vendosur të ngrenë pagat minimale të tyre në terma realë, ndërsa vende të tjera i kanë lënë pagat minimale të ngrira. Kriza ka ekspozuar më tej një sërë

<sup>1</sup> Institutet, praktikat dhe politikat e pagave gjatë krizës financiare dhe ekonomike - Vështrim mbi Ballkanin Perëndimor dhe vende të caktuara anëtare të BE-së, nga Verena Schmidt dhe Daniel Vaughan Whitehead

<sup>2</sup> Sipas kuptimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

<sup>3</sup> Rimëkëmbja nga kriza: Një pakt global për vendet e punës (Gjenevë, Zyra Ndërkombëtare e Punës, 2009).

[http://www.ilo.org/public/libdoc/ilo/2009/109B09\\_101\\_engl.pdf](http://www.ilo.org/public/libdoc/ilo/2009/109B09_101_engl.pdf)

dobësisht strukturale të instituteve dhe politikave të pagave në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Është e rëndësishme të vazhdoen reformat për përmirësimin e përcaktimit të pagës minimale nën dritën e Konventës Nr 131 të vitit 1970 të ILO-s mbi Përcaktimin e Pagës Minimale. Kjo Konventë është ratifikuar nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

### *Bashkërendimi i pagave me produktivitetin*

Në disa nga raportet kombëtare të përgatitura për konferencën (për shembull, raporti mbi Shqipërinë) vihet në dukje se që përpara krizës, pagat lidheshin dobët me performancën ekonomike. Kjo gjë reflektohej në tendencën zbritëse të pjesës që zinin pagat që nga mesi i viteve 90-të në koston e prodhimit. Lidhja e pagave me produktivitetin u lejon atyre të rriten me rimëkëmbjen ekonomike, ndërkohë që sjell njëfarë fleksibiliteti në periudha të ngadalësimit ekonomik, duke ndihmuar në këtë mënyrë në mbajtjen e normave të punësimit. Në nivel ndërmarrjeje, lidhja e një pjese të pagës me performancën mund të përbëjë një instrument të rëndësishëm për stimulimin e produktivitetit.

### *Pagat dhe reformat fiskale*

Në shumë nga vendet e nënrajonit, struktura aktuale e sistemit tatimor të punës (jo vetëm taksa mbi të ardhurat personale, por edhe normat për kontributet e sigurimeve shoqërore) shfaqet e pamjaftueshme dhe jo-efikase. Taksa e sheshtë që mbizotëron në disa vende, si në Serbi, mund të ketë efekte të kundërta mbi pagat neto dhe fuqinë blerëse të punëmarrësve.

Reformat fiskale në lidhje me taksën mbi të ardhurat personale, për shembull në Shqipëri, - ku mbas miratimit të taksës së sheshtë prej 10% nuk ka progresivitet të taksës mbi të ardhurat personale - kanë patur efekte negative mbi punëmarrësit me paga më të ulëta. Gjithashtu kjo gjë ka rritur edhe pabarazinë e pagave dhe njëkohësisht ka çuar drejt një rënieje të konsiderueshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore për punëmarrësit, çka përfaqëson humbje të rëndësishme të të ardhurave shtetërore. Ekzistojnë gjithashtu tregues për rritje të punësimit informal (72 për qind kanë raportuar se pagat e tyre janë informale), sikurse përshkruhet në një vëzhgim të kryer nga ILO në sektorin e ndërtimit (ILO, 2008b).<sup>4</sup>

Çdo hap drejt taksimit progresiv dhe zvogëlimit të barrës fiskale për punëmarrësit me paga të ulëta do të sillte përmirësime në drejtim të efikasitetit edhe drejtësisë sociale. Në të njëjtën kohë, duhet të ndërmerren reforma fiskale për të kufizuar praktikatat e “pagave në zarf” dhe për të motivuar në këtë mënyrë punëdhënësit që në vend të pagës minimale të deklarojnë nivelet e pagave reale të punëmarrësve.

### *Nevojë për mbledhje më sistematike të statistikave të pagave*

ILO ka vënë në dukje një paradoks serioz. Ndonëse pagat mbeten çështja kryesore e bisedimeve kolektive, të dhënat mbi pagat vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme dhe të pasakta. Po kështu edhe vlerësimet mbi minimumin jetik apo kufirin e varfërisë. Një kusht i domosdoshëm për hartimin e politikave efektive të pagave është aksesimi i barabartë si për qeverinë, ashtu dhe partnerët socialë, në informacionin dhe të dhënat përkatëse, si dhe kapaciteti për të kuptuar në tërësi implikimet e vendimeve të politikave të pagave mbi produktivitetin, inflacionin dhe punësimin.

---

<sup>4</sup> ILO. 2008b. 'Duke trajtuar problemin e punës së padeklaruar në sektorin e ndërtimit në Shqipëri nëpërmjet dialogut social', ILO- Shqipëri, Shtator, Tiranë.

*Dialogu social për përshtatje më të mirë të politikave të pagave ndaj krizës*

Në përgjithësi, shumica e punëmarrësve në sektorët ku pagat janë të ulëta nuk mbulohen nga bisedimet kolektive. Për këtë arsye, efikasiteti i dialogut social duhet të përmirësohet me qëllim kufizimin e efekteve të krizës mbi personat që fitojnë paga të ulëta. Diskutimet trepalëshe mund të ndihmojnë në gjetjen e zgjidhjeve konsensuale për tu përballur me burimet e krizës ekonomike dhe sociale. Studimi i ILO-s konkludon se politikat mbi të ardhurat dhe pagat duhet të diskutohen në nivel kombëtar bashkë me çështje të tjera të rëndësishme, si reforma fiskale dhe reforma e pensioneve.

\*\*\*\*\*

*Për më shumë informacion, jeni të lutur të kontaktoni Zyrën Nënrajonale të ILO-s në Budapest në +36-1-473-2656 or [horvathd@ilo.org](mailto:horvathd@ilo.org)*